



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



Raport përfundimtar për të hyrat e lejuara maksimale të OSSH-së

Përgjigjet ndaj Komenteve (OSSH-së)

Periudha e Dytë Rregulative (2018-2022)

DEKLARATË

Ky Raport është përgatitur nga ZRRE-ja me qëllim të informimit të palëve të interesuara të sektorit të energjisë. Ky raport nuk paraqet ndonjë vendim të ZRRE-së dhe nuk duhet të interpretohet si i tillë.

24 Shtator 2018

Përmbajtja

1	Hyrje	3
2	Shpenzimet operative (OPEX).....	4
2.1	Komentet e KEDS-it.....	4
2.2	Komentet FSPE.....	5
2.3	Përgjigjet dhe propozimet e ZRRE-së.....	5
2.4	Lejimi i humbjeve	8
2.4.1	Komentet e KEDS-it	8
2.4.2	Përgjigjet dhe propozimet e ZRRE-së	8
2.5	Baza e Rregulluar e Aseteve.....	8
2.5.1	Komentet e KEDS-it	8
2.5.2	Përgjigjet dhe propozimet e ZRRE-së	9
2.6	Shpenzimet kapitale.....	10
2.6.1	Komentet e KEDS-it	10
2.6.2	Përgjigjet dhe propozimet e ZRRE-së	10
2.7	Përshtatjet PRR1	13
2.7.1	Komentet e KEDS-it	13
2.7.2	Komentet e FSPE	13
2.7.3	Përgjigjet dhe propozimet e ZRRE-së	13
2.7.4	Të hyrat jo-tarifore dhe kostot e përjashtuara – Komenti i KEDS-it.....	14
2.7.5	Përgjigja dhe propozimi i ZRRE.....	14
2.7.6	Vlerësimi i bilancit të energjisë elektrike të realizuar - Komenti i KEDS-it	14
2.7.7	Përgjigja dhe propozimi i ZRRE	15
2.7.8	Përshtatjet për të hyrat e parregulluara – Komentet e KEDS-it	15
2.7.9	Përgjigja dhe propozimi i ZRRE-së	15
2.7.10	Përshtatjet për faktorin korrigjues të të hyrave – KREV – Komentet e KEDS-it	15
2.7.11	Përgjigja dhe propozimi i ZRRE-së	15
2.7.12	Përshtatjet për Humbjet – Komentet e KEDS-it	15
2.7.13	Përgjigja dhe propozimi i ZRRE-së	16
2.8	Përmbledhje e MAR-it të OSSH.....	16



1 Hyrje

Pas vlerësimit fillestar të Aplikacioneve lidhur me të Hyrat e Lejuara Maksimale (MAR) për të licencuarin e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH, KEDS), i licencuari dhe palët tjera të interesit kanë pasur mundësi t'i paraqesin komentet e tyre përmes konsultimit publik për periudhë dy javore.

Me qëllim të vlerësimit sa më të drejtë të MAR për OSSH, përfaqësuesit e ZRRE-së dhe KEDS kanë pasur disa takime për të sqaruar kalkulimet në vlerësimin fillestar. Nga ky proces interaktiv i komunikimit ndërmjet ZRRE-së dhe KEDS-it ka rezultuar në disa plotësime e të cilat janë reflektuar në propozimin përfundimtar të ZRRE-së.

Ky dokument paraqet përgjigjet në komentet e bëra nga palët e interesuara, dhe propozimin e ZRRE-së lidhur me të Hyrat e Lejuara Maksimale të OSSH-së.

Lidhur me vlerësimin fillestar të të Hyrave të Lejuara Maksimale të OSSH-së, ZRRE ka pranuar komente nga KEDS, Sindikata e Punëtorëve të KEDS dhe OJQ "Konsumatori". Komentet e të gjitha palëve janë të shtjelluara më poshtë.



2 Shpenzimet operative (OPEX)

2.1 Komentet e KEDS-it

Shpenzimet operative bazë

KEDS-i ka komentuar se propozimi i ZRRE-së për të përcaktuar vlerën bazë të OPEX-it për PRr2 të barabartë me OPEX-in e lejuar në fund të Periudhës së Parë Rregullative (PRr1) do të thotë që OPEX-i i lejuar është i pamjaftueshëm për të mbuluar kostot e realizuara të KEDS-it.

Në veçanti, KEDS argumenton që OPEX-i i lejuar për PRr1 fillimisht ishte llogaritur duke përdorur OPEX-in e realizuar në vitin 2011 si pikënisje. Që nga viti 2011, kostot e KEDS-it janë rritur ndjeshëm për arsye plotësisht të arsyetueshme. Megjithatë, këto rritje nuk u pasqyruan në OPEX-in e lejuar në PRr1 dhe, si rrjedhojë, gjithashtu janë përjashtuar në OPEX-in e lejuar në PRr2 sipas metodologjisë së propozuar të ZRRE-së.

Arsyet e ofruara nga KEDS-i për rritjen e OPEX-it të realizuar në krahasim me OPEX-in e lejuar gjatë PRr1 janë:

- Nevoja për të punësuar punonjës shtesë për të plotësuar ato që fillimisht janë transferuar nga KEK-u, për shkak të shthurjes së funksioneve të KEDS-it.
- Rritja e pagave të punëtorëve mbi-inflacion që u janë dhënë punonjësve me pagë të ulët në vitin 2014 si përgjigje ndaj protestave dhe veprimeve të grevës.
- Diferenca në mes të normave mesatare të inflacionit të Kosovës dhe BE-së, të cilat kanë çuar në rritje më të shpejtë të kostove se sa të lejimeve, të cilat janë indeksuar sipas indeksit të harmonizuar të çmimeve të konsumatorëve Evropian (HICP).
- Rritja e numrit të konsumatorëve dhe e energjisë që hyn në sistemin e shpërndarjes (EED) që çoi në rritje të OPEX-it.
- Rritja e kostove të karburanteve gjatë PRr1.

Duke pasur parasysh këtë, KEDS-i propozon që:

- Vlera bazë për kostot e lejuara të pagave, kostot e karburantit dhe kostot tjera operative në vitin 2018 duhet të vendosen të barabarta me kostot e realizuara në vitin 2017, me inflacion prej 2%. Kjo paraqet rritjen e pritshme në kostot që vijnë nga rritja e numrit të konsumatorëve dhe EED.
- Vlera bazë për kostot e sigurimit në vitin 2018 duhet të vendoset e barabartë me kostot e realizuara në vitin 2017.
- Vlera bazë për kostot e mirëmbajtjes në vitin 2018 duhet të vendoset e barabartë me lejimin e propozuar nga ZRRE-ja.



Ndryshimet vjetore të kostos

Në komentet e veta, KEDS-i ka kritikuar aplikimin e propozuar nga ZRRE-ja të faktorit të efikasitetit vjetor prej 1.5% dhe asnjë përshtatje tjetër vjetore me arsyetimin se:

- Caqet shumë të larta të efikasitetit të përcaktuara në PRR1 (5% në vit në dy vitet e fundit) nënkuptojnë se ka pak mundësi për efikasitet në PRR2.
- Caqet e efikasitetit nuk marrin parasysh presionet në rritje të kostove nga rritja e vazhdueshme e numrit të konsumatorëve dhe EED.

Propozimi i KEDS-it është që:

- Kostot e lejuara të pagave, kostot e karburantit dhe kostot tjera operative duhet të rriten çdo vit për 2% në terma real gjatë PRR2, duke pasqyruar rritjen e numrit të konsumatorëve dhe EED.
- Kostot e lejuara të riparimit dhe mirëmbajtjes duhet të rriten çdo vit për 1.5% në terma real gjatë PRR2.
- Kostot e lejuara të sigurimit duhet të mbeten konstante në terma real gjatë PRR2.

Vlerësimi i KEDS-it për një rritje vjetore prej 2% të kostove është marrë duke shumëzuar koston mesatare për konsumator me rritjen e numrit të konsumatorëve të parashikuar në mes të vitit 2017 dhe 2018, prej 4%, pas lejimit të faktorit të efikasitetit të supozuar prej 1.5%. Rritja aktuale e kostos që ka rezultuar është 2.4% që me sa duket është rrumbullakësuar në 2%.

Korrigjimi i OPEX-it të vitit 2017

KEDS-i gjithashtu ka vërejtur një gabim të vogël në llogaritjen e OPEX-it të lejuar në vitin 2017, që çon në propozimet e ZRRE-së, në nën-deklarim të vlerës fillestare të OPEX-it të lejuar për PRR2 të cilat rrjedhin nga OPEX-i i lejuar në vitin 2017. Diferenca është përafërsisht 0.082 milion €.

2.2 Komentet FSPE

Shpenzimet operative bazë

Shpenzimet operative është kërkuar nga sindikata që të marrin parasysh edhe nivelizimin e pagave, respektivisht është kërkuar që të kemi parasysh se në KEDS që nga viti 2013 ende ka me qindra vende pune të cilat nuk i kanë të nivelizuara pagesat sipas pozitës, po ashtu në komentet e sindikatës theksohet dallimi ndërmjet nivelit të pagave të KEDS-it dhe të licencuarve tjerë në sektorin e energjisë.

2.3 Përgjigjet dhe propozimet e ZRRE-së

Shpenzimet operative bazë

ZRRE-ja konsideron se qasja e saj në vendosjen e OPEX-it bazë të lejuar është tërësisht në përputhje me parimet që bazohen në kornizën e shqyrtimit shumëvjeçar tarifor, ku të licencuarit (në këtë rast, KEDS) i ofrohet kosto e lejuar dhe është në gjendje të mbajë përfitimet e reduktimit të kostove të realizuara nën këtë nivel dhe rreziqeve të tejkalimit të



tyre. Nëse i licencuari lejohej që të bartë të gjitha ndryshimet në kosto atëherë nuk ka nxitje për menaxhimin më të mirë të këtyre kostove. Prandaj, ZRRE-ja nuk pajtohet që KEDS-i duhet të jetë në gjendje të përfshijë të gjitha tejkallimet e OPEX-it të realizuar mbi nivelet e lejuara në vlerën bazë për PRr2.

Vlen të theskohet se është e arsyeshme që të barten rritjet e mëdha të kostos që dalin nga ndryshimet në obligime ose rrethana tjera jashtë kontrollit të të licencuarit. Në këtë kontekst, ZRRE-ja thekson se lejimi i propozuar i OPEX-it bazë për KEDS përfshinë një përshtatje në rritje prej 2.05 mil€, kjo ka të bëjë me rritjen e kostove të personelit prej 1.65mil€ dhe rreth 0.4mil€ për përvojën e punës. Këto kosto janë në baza vjetore dhe janë të njohura për tërë periudhën rregullative 2018-2022. Kjo rritje e kostove të personelit të KEDS-it është e krahasueshme me kostot e personelit të të licencuarve të tjerë në sektorin e energjisë, që do të thotë se ZRRE ka marrë parasysh komentet e KEDS dhe të Sindikatës. Duhet theksuar se këto kërkesa janë marrë parasysh edhe në Raportin Konsultativ të publikuar me 24 gusht 2018.

ZRRE-ja gjithashtu thekson se punonjësit e KEDS-it janë zvogëluar në numër nga 2,312 në vitin 2015 në 1,958 në vitin 2018. Kjo ofron një fushëveprim mjaft të madh për KEDS-in që të rrisë pagat në të ardhmen, në norma mbi-inflacion ndërkohë që ende mbetet brenda lejimit të përgjithshëm të opex-it.

ZRRE ka pranuar komentin e KEDS lidhur me korrigjimin teknik në OPEX, dhe është aplikuar korrigjimi i OPEX-it të vitit 2017 i cili do të përdoret edhe si OPEX hapës për vitin 2018.

Ndryshimet vjetore të kostos

ZRRE-ja pajtohet që OPEX-i mund të pritet të rritet me rritjen e madhësisë dhe kompleksitetit të rrjetit të shpërndarjes dhe, duke pasur parasysh normat aktuale të rritjes së numrit të konsumatorëve dhe rrjedhimisht madhësisë së rrjetit, propozon që të përfshihet një dispozitë për këtë në lejimin e OPEX-it.

Sfida qëndron në vlerësimin e nivelit të kësaj dispozite. Për të bërë këtë, ZRRE-ja duhet të përcaktojë:

- Shtytësit e rritjeve në OPEX.
- Marrëdhënia e ndryshimeve në OPEX me ndryshimet në këta shtytës.

Propozimet e KEDS-it lidhin rritjet në opex me rritjen e numrit të konsumatorëve. Ata absolutisht supozojnë se, në mungesë të ndonjë fitimi në efikasitet, OPEX rritet për 0.875% për çdo 1% rritje në numrin e konsumatorëve¹ (një elasticitet të kostos prej 0.875).

ZRRE-ja ka dy shqetësime në këtë drejtim:

¹ KEDS-i vlerëson një rritje prej 2% në OPEX si rezultat i rritjes prej 4% të numrit të konsumatorëve, pas aplikimit të një faktori të efikasitetit prej 1.5%. Në mungesë të faktorit të efikasitetit, rritja e nënkuptuar në OPEX është 3.5% që rezulton nga 4% rritja në numrin e konsumatorëve.



- Pikëpamja e ZRRE-së është se shpenzimet operative në shpërndarjen e energjisë elektrike janë të shtyra nga madhësia dhe kompleksiteti i rrjetit. Prandaj, masat siç janë kapaciteti i transformatorit dhe/ose gjatësia e qarkut do të ishin treguesit më të mirë të shtytësve të kostos se sa numri i konsumatorëve. Megjithatë, në mungesë të të dhënave të tilla, numrat e konsumatorëve mund të shërbejnë si një ndërmjetës duke qenë që numrat në rritje nënkuptojnë rritje në madhësi dhe dendësi të rrjetit të shpërndarjes.
- Rrjetet e shpërndarjes së energjisë elektrike në përgjithësi karakterizohen nga ekonomia e shkallës, kështu që OPEX ngritet në mënyrë të konsiderueshme më pak se rritja e madhësisë së rrjetit. Fatkeqësisht, ekzistojnë relativisht pak studime rreth marrëdhënies në mes të kostove dhe madhësisë së shpërndarësit. Një anketë e shpejtë nga ZRRE-ja ka identifikuar një numër të vogël të studimeve të tilla që tregojnë kostot totale (në vend të vetëm OPEX-it) që kanë një elasticitet në lidhje me numrin e konsumatorëve prej 0.09% vetëm për konsumatorët e amvisërisë deri në 0.674% për të gjithë konsumatorët². Në të gjitha studimet e shqyrtuara, elasticiteti mesatar është përafërsisht 0.44.

Duke pasur parasysh shumë paqartësi që janë rreth marrëdhënies në mes të OPEX-it dhe madhësisë së shpërndarësit dhe se si të matet kjo, ZRRE-ja propozon që të përdoren supozimet e mëposhtme në projektimin e OPEX-it për PRR2, duke ditur që këto janë pashmangshëm të thjeshta për nga natyra:

- Madhësia e rrjetit është e përcaktuar nga numri i konsumatorëve. Këta supozohet se rriten në PRR2 me një normë të barabartë me normën mesatare të rritjes gjatë PRR1, rreth [4]% në vit.
- Supozohet një elasticitet prej 0.50 për OPEX në lidhje me numrin e konsumatorëve (p.sh., një rritje prej 1% në numrin e konsumatorëve çon në një rritje prej 0.5% në OPEX, para aplikimit të faktorëve të elasticitetit).
- Një faktor i efikasitetit prej 1.5% në vit vazhdon të aplikohet.

Ky parim është përdorur gjatë përcaktimit të shpenzimeve totale operative në terma real të KEDS, apo sipas shprehjes në vijim: $si (1 + (4\% * 0.50)) / (1 + 1.5\%)$.

Bazuar në atë që u theksua më lartë, në tabelën në vijim është paraqitur lejimi i OPEX-it për PRR2:

² Studimet e shqyrtuara janë: (i) Shpërndarësit francezë të energjisë elektrike (<https://core.ac.uk/download/pdf/6320368.pdf>); (ii) Shpërndarësit italian të energjisë elektrike (https://www.fep.up.pt/conferences/earie2005/cd_rom/Session%20V.V.I/Piacenza_Vannoni.pdf); dhe (iii) shpërndarësit e energjisë elektrike në tetë vende Evropiane (<https://www.eprg.group.cam.ac.uk/wp-content/uploads/2014/01/eprg0504.pdf>).



€000s	-----		PRR2	-----	
	2018	2019	2020	2021	2022
	Propozuar	Propozuar	Propozuar	Propozuar	Propozuar
Propozimet e ZRRE-së					
Riparimet dhe Mirembajtja	4,032	3,971	3,911	3,853	3,795
Shpenzimet tjera operative	21,900	21,633	21,371	21,115	20,864
Qiraja per asetet e Trepçes*	246	246	246	246	246
Kostot e perjashtuara	0	-408	-408	-408	-408
Të hyrat e parregulluara	-3,500	-3,500	-3,500	-3,500	-3,500
Total OPEX	22,678	21,942	21,621	21,306	20,997

2.4 Lejimi i humbjeve

2.4.1 Komentet e KEDS-it

ZRRE ka përdorur me saktësi volumet e energjisë elektrike siç janë parashikuar nga OSSh, megjithatë energjia në hyrje të sistemit të shpërndarjes (EED) llogaritet në bazë të nivelit të lejuar të humbjeve, që matematikisht është korrekt, por që realisht nuk përfaqëson EED aktuale të pritur për vitin 2018. Në këtë kuptim, për të qenë të drejtë dhe për të shmangur përshtatjet e mëdha në vitet e ardhshme, OSSh sugjeron të aplikoj vlerat e sakta kur llogaritet EED për vitin 2018 dhe më tej.

2.4.2 Përgjigjet dhe propozimet e ZRRE-së

Bilanci i energjisë elektrike i ndërtuar gjatë parashikimeve vjetore dhe shumëvjeçare bazohet në qasjen poshtë-lartë (duke filluar nga konsumi). Kjo qasje përdoret me qëllim që ndërmarrjet të jenë më eficiente gjatë blerjeve të energjisë, ashtu që kostot e furnizimit të konsumatorëve të jenë më të ulta. Gjithsesi, në rast të dallimeve ndërmjet volumit aktual të energjisë së hyrë në distribucion (EED) në krahasim me atë të parashikuar dhe dallimeve ndërmjet çmimit për blerjen e humbjeve të lejuara në krahasim me ato të realizuara, ZRRE do t'i bëjë përshtatjet në baza vjetore.

2.5 Baza e Rregulluar e Aseteve

2.5.1 Komentet e KEDS-it

Vlera e hapjes

KEDS-i ka theksuar dy shqetësime në llogaritjen e hapjes së Bazës së Rregulluar të Aseteve (BAR) për PRR2:

- Jetëgjatësia e asetëve e përdorur për llogaritjen e zhvlerësimit të asetëve ekzistuese (ato të përfshira në hapjen BAR në fillim të PRR2) është llogaritur si jetëgjatësia e mbetur në vitin 2017. Sidoqoftë, llogaritja faktikisht duhet të përdorë jetëgjatësinë e mbetur në vitin 2018 (dmth, kur kjo jetëgjatësi e mbetur ka rënë për një vit). KEDS-i propozon që të bëhet kjo përshtatje.
- Ka mospërputhje në mënyrën se si hapja e BAR në fillim të PRR2 është azhurnuar për inflacion gjatë PRR1. Ky azhurnim kërkon që shtesat në BAR (capex) dhe zhvlerësimi gjatë



PRr1, të cilat më parë janë shprehur në terma real, të konvertohen në vlera nominale duke u përshtatur për inflacion. Për shembull, shtesat në BAR për vitin 2016 ishin, për qëllime të llogaritjes së të hyrave të lejuara për PRr1, fillimisht të shprehura në çmimet e vitit 2013 (dmth, nivelet e çmimeve në fillim të PRr1)³. Këto tani duhet të azhurnohen me çmimet e vitit 2018, duke përfaqësuar pikënisjen për PRr2. Shqetësimi i KEDS-it është që për dy kategori të aseteve (asetet 35 vjeçare dhe 5 vjeçare) kjo është bërë në baza kumulative duke përfshirë inflacionin nga viti 2013 ndërsa për kategorinë e aseteve me jetëgjatësi prej 20 vite, nuk është bërë. KEDS-i propozon që të ndryshohet llogaritja që të jetë kumulative për të gjitha kategoritë e aseteve⁴.

MPKK dhe zhvlerësimi i aseteve të para-PRr2

KEDS-i gjithashtu ka komentuar që është një mospërputhje që të llogaritet zhvlerësimi për asetet e komisionuara para PRr2 duke përdorur jetëgjatësinë e miratuar më herët të aseteve, por të llogaritet kthimi i lejuar duke përdorur vlerën PRr2 MPKK. KEDS-i propozon që ose të përdoret jetëgjatësia e miratuar më herët e aseteve dhe vlera PRr1 MPKK ose të përdoret jetëgjatësia e rishikuar e aseteve e miratuar për asetet e komisionuara në PRr2 dhe më pas edhe vlera PRr2 MPKK.

2.5.2 Përgjigjet dhe propozimet e ZRRE-së

ZRRE-ja ka rishikuar me kujdes lëshimet teknike eventuale dhe propozimet për korrigjimet e dhëna nga KEDS. ZRRE ka vërejtur se KEDS ka korrigjuar jetëgjatësinë e aseteve për një (1) vit ashtu siç është kalkuluar nga ZRRE për të gjitha kategoritë e aseteve të PRr1. Pas rishikimit të ZRRE-së, vërehet se korrigjimi i vlerave për jetëgjatësinë e mbetur të aseteve nuk duhet zvogëluar vetëm për një vit por ato janë ri-kalkuluar për të marrë në konsideratë edhe shtesat (investimet) gjatë vitit 2017. ZRRE-ja më parë ka ndarë modelin e MAR-it të përdorur për llogaritjet e saj me palët e interesit dhe do ta ofroj këtë prapë me shënime sqaruese që shpjegojnë llogaritjet e bëra.

Për sa i përket konsistencës së jetëgjatësisë së aseteve dhe vlerave të MPKK, ZRRE-ja thekson se është praktikë standarde në agjencitë rregullatore që të aplikojnë të njëjtën MPKK për të gjitha asetet kur të llogaritet kthimi i lejuar dhe e bëjnë atë duke përdorur vlerën më të fundit të miratuar të MPKK. Kjo është në përputhje me trendin e ndryshimeve të MPKK-ut në tregjet financiare (p.sh., rënia e madhe e normave të interesit global). Nëse bëhet ndryshe, për shembull, të lejohet i licencuari të realizoj fitimet e papritura duke vazhduar që të marrë një MPKK të vendosur në kohë të normave të interesit shumë më të larta por të jenë në gjendje që të ri-financojnë kreditë e tyre me normat e interesit aktual, shumë më të ulëta.

³ Brenda PRr1, tarifat u indeksuan me inflacion. Prandaj, kjo përshtatje për inflacion automatikisht është përfshirë në nivelet e tarifës. Megjithatë, BAR tani duhet të ri-bazohet në fillim të PRr2 për të lejuar inflacionin pasi që vlerat origjinale janë caktuar në fillim të PRr1.

⁴ KEDS-i gjithashtu ka shprehur preferencën për përshtatjet vjetore të zhvlerësimit dhe kthimeve të lejueshme për diferencat në mes të capex-it të realizuar dhe lejuar, në vend që të azhurnohet BAR me capex-in e realizuar në fillim të çdo periudhe shumëvjeçare.



ZRRE me Udhëzimet Rregulltore të Kontabilitetit ka sqaruar këtë çështje ku citohet “Me qëllim të llogaritjes së bazës së rregulluar të aseteve, të licencuarit mund të llogarisin zhvlerësimin e shpenzimeve kapitale të ndërlidhur me periudhat e mëparshme rregullative duke shfrytëzuar një jetëgjatësi mesatare të mbetur të aseteve për secilën kategori të aseteve, në vend të mbajtjes së zhvlerësimit në baza vjetore sipas shpenzimeve kapitale historike. Gjatë llogaritjes së mesatares së jetëgjatësisë së mbetur të aseteve për secilën kategori të aseteve, i licencuari duhet të sigurohet që vlera e zhvlerësimit të lejuar për periudhën rregullative të jetë e pandryshuar”. Pra, ZRRE do të mbajë qëndrim konsistent lidhur me jetëgjatësinë për sektorin e energjisë.

Lidhur me shqetësimin e KEDS për aplikimin e normës së përbërë të interesit për përshtatjet për investimet kapitale për dallimet në mes të realizimeve dhe lejimeve të PRR1, ZRRE ka vepruar në përputhje me rregullat dhe parimet rregullatore. Trajtimi i njëjtë bëhet në të dy rastet, si kur diferenca në përshtatje del pozitive ndaj të licencuarit po ashtu edhe në rastet kur ajo është negative.

2.6 Shpenzimet kapitale

2.6.1 Komentet e KEDS-it

Në komentet e saj, KEDS ka deklaruar e MAR i propozuar është i pamjaftueshëm për të qenë në gjendje që të financojë programin e miratuar të investimeve ashtu siç është në Raportin Konsultativ të ZRRE-së, me një total prej 131.4 mil€ për PRR2. Prandaj, KEDS-i propozon që të reduktojë programin e saj të investimeve gjatë PRR2 në një total prej 61.1 mil€. Reduktimet më të mëdha të propozuara janë në investimet në rrjetin e TM (të reduktuara për 40.7 mil€ ose 88%) dhe në stacionet e transformatorëve (reduktuar për 14.7 mil€ ose 85%). Në të njëjtën kohë, investimet në rrjetin e TU propozohet të rriten për 12.7 mil€ ose 47% në krahasim me programin e propozuar të investimeve. KEDS-i nuk ka ofruar një arsyetim të detajuar se si janë zhvilluar këto ndryshime, cilat projekte dhe programe ndikohen dhe ndikimi potencial në cilësinë e shërbimeve të saj.

KEDS-i gjithashtu ka deklaruar se: “...investimet e reja të propozuara kërkojnë që të merret hua...pasi që nuk mund të financohen me paratë vetanake të gjeneruara”. Në komentet e veta, KEDS-i argumenton se kjo nuk është në përputhje me supozimin e një raporti të gearing prej 40% të përdorur në llogaritjen e MPKK dhe me përgjegjësinë e ZRRE-së për t’u siguruar se ajo mbetet financiarisht e zbatueshme.

2.6.2 Përgjigjet dhe propozimet e ZRRE-së

Përshtatshmëria e rrjedhës së parasë

ZRRE-ja thekson se KEDS-i, në komentet e saj, nuk ka ofruar ndonjë parashikim të rrjedhës së parasë por thjeshtë ka pohuar se nuk do të jetë në gjendje të financojë programin e investimeve të propozuara më parë. Prandaj, ZRRE-ja nuk është në gjendje që të vlerësojë arsyeshmërinë e supozimeve në të cilat bazohet ky pretendim.

Në mungesë të një analize të tillë, ZRRE-ja ka përgatitur parashikimet e veta të rrjedhës së parasë për të vlerësuar nëse ky shqetësim është i arsyeshëm. Këto parashikime për nga



natyra janë thjeshtësuar shumë dhe kanë për qëllim që të 'kontrollojnë-kuptimin' e pretendimit të bërë nga KEDS-i. Ato bëjnë këto supozime kryesore:

- MAR i KEDS-it dhe programi i investimeve janë ashtu siç janë propozuar në Raportin Konsultativ të ZRRE-së.
- Salldoja fillestare e KEDS-it për borxhin afatgjatë është i barabartë me pjesën jo-aktuale të kredive afatgjata ashtu siç tregohet në pasqyrat financiare të vitit 2017, prej 7.45 milion €. Dy këste të mbetura të ri-pagesës janë për t'u paguar, prej 4.80 milion € në vitin 2018 dhe 2.65 milion € në vitin 2019.
- Gearingu (leverazhi) i KEDS-it (llogaritur si *borxh / BAR*) nuk do të duhej të tejkalojë nivelin 40% të përdorur në llogaritjen e MPKK, që përfaqëson pikëpamjen e ZRRE-së për një raport të përgjithshëm të qëndrueshëm të gearingut (leverazhi).
- Duke e njohur këtë kufizim në gearing të përgjithshëm, CAPEX-i i ri supozohet të jetë 60%- i financuar nga borxhi, si një supozim konservativ. Kjo rezulton në ngritjen e gearing të KEDS-it deri në 20% në vitin 2022, krahasuar me vlerën 40% në llogaritjen e MPKK. Kjo ofron një "zbutës" të konsiderueshëm kundrejt goditjeve të papritura duke mbajtur gearing mjaft nën nivelin 40% dhe gjithashtu duke lejuar rritje në të ardhmen në stokun e borxhit afatgjatë.
- Kreditë e reja, paguhen për pesë vjet (kushtet e kredive ekzistuese të KEDS-it për shpenzimet kapitale). Edhe kjo për nga pikëpamja e ZRRE-së është një supozim konservativ.

Këto parashikime të thjeshtësuara sugjerojnë se KEDS-i duhet të jetë në gjendje që të financoj programin e vetë të investimeve ashtu siç është miratuar fillimisht nga ZRRE-ja si të plotë dhe ende të gjeneroj rrjedhje pozitive të parasë në secilin vit të PRr2. Kjo mundëson që KEDS të ketë një rrjedhë të parasë pozitive gjatë PRr2.

Duke pasur parasysh këtë, ZRRE-ja konsideron se shqetësimet e ngritura nga KEDS-i në lidhje me aftësinë e saj për të financuar programin e investimeve të miratuar nuk janë të arsyetuara.



Tabela 1: Parashikimet rrjedhës së parasë, PRR2

Rrjedha e parase - analizë							
OSSH	Unit	2018	2019	2020	2021	2022	Total
MAR-i Perfundimtar	€000s	83,462	83,178	82,951	82,279	81,380	413,250
Opex-i	€000s	(26,178)	(25,850)	(25,529)	(25,214)	(24,905)	(127,676)
Capex-i	€000s	(28,483)	(33,737)	(28,846)	(20,510)	(19,867)	(131,443)
Hua marrjet	€000s	17,090	20,242	17,308	12,306	11,920	78,866
Pagesa e borxhit	€000s	(5,336)	(6,180)	(7,460)	(10,676)	(11,888)	(41,541)
Blerjet e humbjeve	€000s	(37,551)	(34,906)	(32,650)	(30,412)	(27,964)	(163,482)
Rrjedha e parasë neto	€000s	3,005	2,747	5,774	7,773	8,676	27,975
Financimi i CAPEX-it nga borxhi		60.0%	60.0%	60.0%	60.0%	60.0%	
Kostoja e borxhit	Unit	2018	2019	2020	2021	2022	Total
BAR	€000s	159,650	175,905	195,199	208,816	213,161	
Borxhi (salldo fillestare)							
- egzistues	€000s	7,447	2,647	-	-	-	
- te reja	€000s	-	12,290	27,427	39,250	43,706	
Gearingu mesatar (leverazh)%		0.0%	7.0%	14.1%	18.8%	20.5%	
Maturiteti (borxhi i ri)	years	5	5	5	5	5	
Norma e interesit	%	7.2%	7.2%	7.2%	7.2%	7.2%	
Kostoja e interesit	€000s	536	1,075	1,975	2,826	3,147	9,559
Principali	€000s	4,800	5,105	5,485	7,850	8,741	31,981
Pagesa e borxhit	€000s	5,336	6,180	7,460	10,676	11,888	41,541

Burimet: Llogaritjet ZRRE

Programi i investimeve gjatë PRR2

Përgjegjësia e ZRRE-së në lidhje me miratimin e shpenzimeve kapitale është që të rishikoj programin e investimeve të propozuara dhe të sigurohet që projektet që përmbahen në të janë të nevojshme për të licencuarin për të përmbushur obligimet e veta dhe se kostot e vlerësuara janë të arsyeshme. ZRRE-ja veç ka kryer një rishikim të tillë për KEDS-in dhe, siç është përcaktuar në Raportin Konsultativ të saj, investimet e miratuara me një total prej 131.4 milion € gjatë periudhës PRR2, krahasuar me 153.9 milion € të propozuara fillimisht nga KEDS-i.

KEDS-i tani është duke propozuar që të reduktohet programi i saj i investimeve gjatë PRR2 në 61.1 milion €. Pozicioni i ZRRE-së në këtë drejtim është se:

- ZRRE-ja veç ka vlerësuar ato dhe i konsideron programin e investimeve të arsyeshme dhe të arsyetueshme për PRR2, në përputhje me obligimet e licencës së KEDS-it. **Prandaj, ZRRE-ja nuk propozon ndryshimin e llogaritjes së MAR për propozimet e rishikuara të dorëzuara nga KEDS-i sipas propozimeve të tij të dhëna në Raportin Konsultativ.**
- Pas përfundimit të PRR2, ZRRE do të përshtatë MAR për periudhën pasuese rregullative për çdo diferencë në mes të zhvlerësimit dhe kthimit të realizuar dhe lejuar në PRR2 që kanë lindur nga diferencat në mes të shpenzimeve kapitale të



realizuara dhe lejuara gjatë të njëjtës periudhë. Në rast se ka dallime të theksuara ndërmjet investimeve të lejuara dhe atyre të realizuara, ZRRE mund të bëjë këto përshtatje në baza vjetore.

2.7 Përshtatjet PRR1

2.7.1 Komentet e KEDS-it

KEDS-i ka propozuar se do të ishte më e përshtatshme që të aplikohet Indeksi i Harmonizuar i Çmimit të Konsumatorit (HICP) të Kosovës për të indeksuar kostot dhe çmimet ndaj inflacionit, në vend të (HICP) në Eurozonë që aktualisht përdoret për llogaritjen e përshtatjeve brenda secilës periudhë shumëvjeçare. Argumenti i KEDS-it është që HICP e Kosovës reflekton më mirë koston e jetesës në Kosovë e cila nga ana tjetër, shtynë kostot e pagave.

2.7.2 Komentet e FSPE

Ne konsiderojmë që matje reale e inflacionit në Kosovë duhet të jetë mesatarja e vendeve me të cilat kemi marrëdhënie të avancuara tregtare si: Serbia, Maqedonia, Shqipëria e Mali i Zi ku mesatarja e normës së inflacionit të jetë 2.45%, siç u argumentua më lartë, e jo ashtu siç është prezantuar në raportin konsultativ.

2.7.3 Përgjigjet dhe propozimet e ZRRE-së

ZRRE-ja nuk pajtohet me propozimin e KEDS-it me arsyetimin se kostot e KEDS-it janë të ndikuara më shumë nga kostot e mallrave kapitale, shumica e të cilave importohen, se kostot e pagave.⁵ Si pasojë, HICP e Eurozonës është një matje më e përshtatshme e ndryshimeve të kostos. Për më të tepër, Kosova ka si valutë zyrtare Euron si dhe nëse analizohet trendi i inflacionit në Kosovë dhe Eurozonë, mund të shohim që Eurozona zakonisht ka inflacion të përafërt me atë të Kosovës.


ZRRE-ja gjithashtu thekson se, gjatë vitit të kaluar, HICP e Kosovës është rritur më ngadalë se sa HICP e Eurozonës, siç tregohet më poshtë. Prandaj, ndryshimi i propozuar do të çonte në tarifa më të ulëta për KEDS-in se sa që do të ishte rasti nëse vazhdohet me aranzhimet ekzistuese të indeksimit.

Gjithashtu, përdorimi i HICP të Eurozonës është i specifikuar në Rregullën për Çmimet e OSSh-së të nxjerrë nga ZRRE-ja. Ndryshimi i indeksit të inflacionit do të kërkonte një ndryshim të Rregullës për Çmimet e cila do t'i nënshtrohej proceseve të konsultimit dhe miratimit para se të hyjë në fuqi. Prandaj, nuk është praktike të bëhet kjo para fillimit të PRR2.

⁵ Kostot e pagave përfaqësojnë rreth dy të tretat e shpenzimeve operative të cilat, nga ana tjetër, janë rreth gjysma e të hyrave të lejuara (përfshirë humbjet e shpërndarjes).



Tabela 2: Krahasimi i HICP-së (Eurozona dhe Kosova)



Burimet: Eurostati dhe Agjencia e Statistikave të Kosovës

2.7.4 Të hyrat jo-tarifore dhe kostot e përjashtuara – Komenti i KEDS-it

OSSH-ja për periudhën e dytë rregullative ka parashikuar që edhe të hyra jo-tarifore të përfshihen në parashikimin e MAR-it, megjithëse vazhdimisht ka kërkuar që t'i mbajë këto të hyra, duke përjashtuar kostot e shkaktuara nga OSSH-ja përmes tarifave për realizimin e tyre.

ZRRE në propozimin e saj ka ulur OPEX-in për kostot e përjashtuara prej 0.4 milion €, të cilat duhet t'i mbeten OSSH-së nëse do të zvogëlohen të hyrat e parregulluara nga MAR-i.

2.7.5 Përgjigja dhe propozimi i ZRRE

Të hyrat jo tarifore të cilat KEDS i realizon gjatë ofrimit të shërbimeve të ndryshme ndaj konsumatorëve dhe operatorëve të tjerë ekonomik të cilët shfrytëzojnë asetet për të cilat kanë kontribuar konsumatorët e rregulluar janë të hyra nga aktivitetet e pa-rregulluara dhe ato do të zbriten gjatë kalkulimit të MAR-it. Ndërsa lidhur me kostot e përjashtuara, ZRRE pranon komentin e KEDS-it dhe do t'i përshtat këto kosto vetëm për vitin 2018, ngase në vitet e ardhshme pritet e aplikohet Metodologjia e Taksave për kyçje në OSSH.

2.7.6 Vlerësimi i bilancit të energjisë elektrike të realizuar - Komenti i KEDS-it

Faturimi i OSSH-së për qëllimet e MAR-it është dorëzuar në ZRRE gjatë procesit të përshtatjes vjetore në fillim të janarit të vitit 2018, i cili raport është përdorur nga ZRRE për përcaktimin e MAR-it për periudhën e dytë rregullative. Megjithatë, OSSH gjatë raportimit vjetor, në fund të janarit 2018 ka raportuar në mënyrë të saktë vlerat e faturimit, me të gjitha detajet relevante, por siç duket ZRRE nuk i ka përdorur përcaktuesit e faturimit të korigjuara gjatë procesit të përcaktimit të MAR-it për periudhën e dytë rregullative.



2.7.7 Përgjigja dhe propozimi i ZRRE

Bazuar edhe në informatat e fundit nga KEDS lidhur me përcaktuesit e faturimit për kategoritë tarifore (35kV, 10kV dhe 0.4kV) në OSSh vërehet se një pjesë e energjisë është alokuar në kategorinë tarifore 0.4kV, por megjithatë edhe rreth 50GWh kanë mbetur si energji e pa-balancuar. Ndaj kësaj energjie të mbetur janë aplikuar çmimet përkatëse të nivelit 0.4kV me qëllim të kalkulimit të të hyrave përfundimtare të KEDS.

2.7.8 Përshtatjet për të hyrat e parregulluara – Komentet e KEDS-it

Bazuar në Raportet Financiare të hartuara dhe të mbyllura në mars të vitit 2018, ZRRE ka zbritur të hyrat totale të përdorura për qëllime kontabiliteti. Duhet të theksohet se pjesa 'Zvogëlimi i zhvlerësimit të asetëve fikse' të prezantuara në Raportin Financiar si të hyra për qëllime kontabiliteti, nuk duhet të konsiderohen si të hyra nga rregullatori gjatë përcaktimit të MAR-it, pasi kjo linjë nuk përfaqëson të hyra aktuale, respektivisht nuk është lëshuar asnjë faturë dhe përkatësisht nuk ka pasur qarkullim të parave.

Gjithashtu për pjesën "jo-balancat e energjisë" ne besojmë se rregullatori padrejtësisht ka zbritur të hyrat, pasi kjo pjesë paraqet përpjekjet e OSSh për të ndihmuar sistemin të qëndrojë në balancë. Kostot e jo-balancës kompensojnë koston e blerjes së energjisë për përmbushjen e nevojave të humbjeve dhe duhet të trajtohen së bashku me energjinë për humbje, e jo si të hyra të ndara. Nëse këto të hyra do të zbriten nga MAR-i i OSSh-së, atëherë ZRRE duhet të njohë edhe kostot e blerjes për humbjet e tejkaluara.

2.7.9 Përgjigja dhe propozimi i ZRRE-së

ZRRE ka pranuar komentin e KEDS-it lidhur me "Zvogëlimi i zhvlerësimit të asetëve fikse" (impairment) dhe ka korrigjuar të hyrat e pa rregulluara për kostot që kanë të bëjnë me këtë linjë, ndersa lidhur me të hyrat e realizuar nga jobalancet ZRRE konsideron se menaxhimi i tyre në parim bëhet në bazë të ofertës nga OSSh ndaj konsumatorëve për menaxhimin e jo-balancave në sistem, duke qenë se ky bilanc pozitiv ka rezultuar nga aspektet e nominimit se sa ato të shërbimit, ZRRE ka zbritur të hyrat e tilla.

2.7.10 Përshtatjet për faktorin korrigjues të të hyrave – KREV – Komentet e KEDS-it

Për shkak të gabimeve teknike të shpjeguara në detaje në kapitullin 'VII.ii. Vlerësimi i Bilancit të energjisë elektrike të realizuar - Korrigjimi në faturim' shitjet aktuale janë konsideruar në mënyrë jo të duhur.

2.7.11 Përgjigja dhe propozimi i ZRRE-së

ZRRE ka rishikuar pretendimet e ofruara nga KEDS dhe ka rikalkuluar faktorin korrigjues të të hyrave, i cili pas korrigjimeve të hyrat aktuale të rregulluara rezultojnë të jenë 76.18 €m, krahasuar me ato të vlerësuara në raportin konsultativ prej 77.25 €m.

2.7.12 Përshtatjet për Humbjet – Komentet e KEDS-it

ZRRE ka përshtatur me të drejtë objektivat e humbjeve për 1.9%, të cilat ishin humbjet e trashëguara nga mbajtësi i mëparshëm i licencës dhe të cilat në periudhën e parë rregullative paraqiten një barrë shtesë për OSSh-në, mbi çaqet agresive të vendosur për zvogëlimin e humbjeve.



Megjithatë, ZRRE-ja kur pranoi t'i njoh humbjet e trashëguara prej 1.9%, nuk kanë marrë parasysh efektin e përbërë të tij gjatë periudhës së parë rregullative, për të cilën OSSH-ja kërkon kompensim këtë raport. Vetëm 1.9% e EED-së aktuale për periudhën 5 vjeçare përfaqësojnë një kompensim prej 22.3 milion € .

2.7.13 Përgjigja dhe propozimi i ZRRE-së

Bordi i ZRRE-së me datën 20 gusht 2018 ka marrë vendim për Cakun e reduktimit të humbjeve dhe lakoren e humbjeve të lejuara për periudhën e dytë rregullative, pas një faze të gjatë të konsultimit publik. Njohja e caktimit të humbjeve prej 1.9% në PRR2 nuk nënkupton rishikimin e lakores së humbjeve në PRR1.

2.8 Përmbledhje e MAR-it të OSSH

Pas vlerësimit të të gjitha të dhënave në dispozicion dhe ato të paraqitura nga palët e përfshira në proces dhe palët e interesit, si dhe pas komenteve të pranuar nga KEDS, FSPE dhe OJQ "Konsumatori" gjatë konsultimit publik, duke marrë në konsideratë edhe vendimet e Bordit të ZRRE-së për vlerat hyrëse për PRR2, vlerësimi dhe propozimi përfundimtar i ZRRE-së për të Hyrat e Lejuara Maksimale për Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes (KEDS) për periudhën e dytë rregullative 2018-2022 është si më poshtë:

€000s	PRR2				
	2018	2019	2020	2021	2022
	Propozuar	Propozuar	Propozuar	Propozuar	Propozuar
Baza e Opex-it	26,178	25,850	25,529	25,214	24,905
Kosto e humbjeve	37,551	34,906	32,650	30,412	27,964
Zhvlerësimi	12,229	14,443	15,229	16,165	17,547
Kthimi i Lejuar	11,716	13,390	14,955	15,899	16,374
Obligimet ndaj OS dhe OT	793	-	-	-	-
Kostot e përjashtuara	-	-408	-408	-408	-408
Të hyrat jo-tarifore	-3,500	-3,500	-3,500	-3,500	-3,500
Përshtatjet 2017- nivelizuar	-1,164	-1,164	-1,164	-1,164	-1,164
Përshtatjet PRR1- nivelizuar	-339	-339	-339	-339	-339
Totali MAR-i i propozuar	83,462	83,178	82,951	82,279	81,380



Komentet e OJQ Konsumatori

OJQ “Konsumatori” ka komentuar Raportet Konsultative për MAR për PRR2 (1 prill 2018 - 31 mars 2023). Poashtu OJQ “Konsumatori” ka dërguar edhe kontributet e mëhershme nga viti 2008, shkresat, reagimet, publikimet në media, takimet me palët e interesit etj.

Koment: OJQ “Konsumatori” mendon se ZRRE është në vonesë me aplikimin e përcaktimit të të Hyrave të Lejuara Maksimale (MAR) për OST/OT dhe OSSH. Kjo vonesë sipas OJQ Konsumatori, arsyeton “përshpejtimin / shkurtrimin / kalimin e fazës së diskutimit publik duke dhënë vetëm një paralajmërim të cilin, që në hyrje të Raportit...tenton “ta zhbëj” me një arsyetim duke thënë se dokumenti nuk ka formë finale”?!)

Përgjigja e ZRRE-së

ZRRE për arsye të mungesës së kuorunit të Bordit e kishte të pamundur të merrte vendimin lidhur me parametrat rregullativ, përkatësisht për të hyrat e lejuara maksimale për PRR2. Këto vonesa nuk mund të ndikojnë negativisht në tarifat e konsumatorëve fundorë, ngase bazuar në kornizën ligjore dhe rregullative, i gjithë procesi i shqyrtimit periodik ka kaluar përmes konsultimeve publik dhe të gjitha komentet nga palët e interesit trajtohen me mjaft kujdes nga Rregullatori.

Koment: Kur do të fillojë të aplikohet modeli i “...furnizimit të garantuar përmes Furnizuesit të Mundësisë së Fundit (FMF)6 “...?”

Përgjigja e ZRRE-së

Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) me vendimin Vendimi V_977_2018 të datës 13 prill 2018, ka caktuar KESCO, që të ushtrojë përkohësisht funksionin e Furnizuesit të Mundësisë së Fundit. Ky obligim i është dhënë KESCO-së për një periudhë 6 mujore duke filluar nga data 13 qershor deri më 13 dhjetor 2018.

Furnizuesi i mundësisë së Fundit/garantuar do të kryej shërbimin e furnizimit me energji elektrike për konsumatorët të cilët nuk kanë mundur të kontraktajnë vetë një furnizues ose kanë humbur furnizuesin e tyre. Tarifat për kryerjen e shërbimit të furnizimit me energji elektrike do të jenë me kushte të rregulluara duke i mbuluar kostot e arsyeshme për t'i furnizuar me energji elektrike konsumatorët përkatës, në përputhje me Rregullën e Furnizuesit të mundësisë së Fundit.

Koment: Te përlllogaritja e kostove të KEK-ut mendoj se menjëherë e retroaktivisht duhet të ndalet faturimi i 6,9 % në emër të mbulimit të dëmeve nga shpërthimi në KEK më 06.06.2014.

Përgjigja e ZRRE-së

ZRRE asnjëherë nuk e ka njohur dëmin e KEK-ut që është shkaktuar nga shpërthimi i vitit 2014, në mungesë të një raporti që dëshmon se shpërthimi ishte jashtë kontrollit të të licencuarit. Prandaj konsumatorët e energjisë elektrike nuk janë ngarkuar me koston e këtij shpërthimi. Mungesa e energjisë së prodhuar nga KEK-u është dashur të mbulohej nga importi i energjisë.



Duhet të theksohet se me ndryshimet e fundit ligjore, ZRRE nuk rregullon më çmimet e prodhimit për gjeneratorët publik KEK, por ato i nënshtrohen kushteve të tregut.

Koment: Menjëherë duhet të zhdëmtohen 30.000 qytetarët konsumatorë taksapagues të energjisë elektrike me njehsorë digjitalë. Të pakënaqurve të iu ndërrohen njehsorët;

Përgjigja e ZRRE-së

Sipas vendimit të Agjencisë së Metrologjisë së Kosovës nr. AMK-020/2014 të datës 05.12.2014 është vendosur për heqjen e miratimit të tipit të njehsorit **AEL-TF.04-01 të prodhuesit KOHLER**. ZRRE në vazhdimësi pas nxjerrjes së këtij vendimi ka kërkuar nga KEDS informata mbi largimin e njehsorëve elektrik të tipit "AEF.TF-01" të prodhuesit "Kohler". Bazuar në informatat e ofruara nga KEDS si dhe me disa kërkesa të ndara për disa konsumatorë janë larguar nga matja të gjithë këta njehsorë dhe janë zëvendësuar me njehsorët e tjerë elektrik. Po ashtu ZRRE është informuar se për këtë tip njehsori është filluar procesi Gjyqësor lidhur me licencimin e këtyre njehsorëve dhe se me përfundimin e procesit Gjyqësor do të njoftohen të gjitha palët.

Koment: ZRRE-ja duhet të gjejë "formulë" dallimi mes "eksportit" dhe "depozitimit", duhet ta ndalojë lojën e eksportit të energjisë vendore me çmim prej 30 EUR/MWh dhe importimin e të njëjtës energji elektrike, por tani si prodhim i huaj, me çmim deri në 182 EUR/MWh. ZRRE-ja duhet ta ndalojë logjikën e importit fiktiv, importit të manipuluar...; Ndërprerjet e reduktimet e rreme të energjisë elektrike (me qëllim eksporti përfitues), ZRRE-ja duhet t'i ndëshkojë dhe, edhe në këtë mënyrë, ta mbroj qytetarin konsumator taksapagues?!

Përgjigja e ZRRE-së

Kostoja e Importit për furnizim me energji elektrike është komponent që i shtohet blerjeve të energjisë elektrike dhe është kosto e bartshme të kostot e sistemit. Zakonisht energjia e importuar është e kohës së pikut apo e blerë një ditë-para, ndërsa energjia që eksportohet gjatë kohës së natës kur kërkesa vendore bie nën nivelin e gjenerimit. Për këtë arsye çmimet e tregut janë përcaktuese të këtyre çmimeve dhe çmimet e importit janë më të larta se çmimet e eksportit.

Koment: ZRRE-ja, MF-ja, ATK-ja...Qeveria duhet ta shfaqin TVSH-në, të na dëshmojë e bind se ku shkojnë kontributet tona fiskale, të na bind e dëshmojë se ato nuk keqpërdoren.

Përgjigja e ZRRE-së

ZRRE në kostot e lejuara operative dhe kapitale nga të cilat përcaktohen të hyrat e lejuara maksimale (MAR) nuk merr parasysh TVSH dhe tatimet në fitim, dhe ky është tatim i ndarë nga tarifatat të cilat i përcakton ZRRE.

Koment: ZRRE-ja nuk ka pasur të drejtë që koston e individëve që konsumojnë energji elektrike e që nuk paguajnë të ua faturojë qytetarëve konsumatorë pagues të ndershëm, të kujdesshëm e me potencë të dukshme të patriotizmit ekonomik. Këtë logjikë e mendësi papërgjegjësie ZRRE-ja duhet ta ndërpres dhe retroaktivisht t'i zhdëmtojë qytetarët konsumatorë. Në këtë aspekt, jo vetëm qytetarët konsumatorë, ZRRE duhet t'i vetëdijësojë edhe zyrtarët e vet, të KEK, të KOSTT, të KEDS, të Qeverisë, të MZHE-së...të cilët mendojnë e janë të bindur, deklarohen edhe publikisht se "...humbjet duhet mbuluar nga qytetari konsumator pagues i ndershëm e patriot ekonomik..." ?!



Në kontratën me qytetarin konsumator të energjisë elektrike dëmet / borxhet për energjinë elektrike të konsumuar e të papaguar nga “pala e tretë” decidivisht është thënë se nuk do të ngarkohet qytetari konsumator. Kjo u tha edhe në press konferencën e Këshillit për Mbrojtjen e Konsumatorit mbajtur në MTI më 30.09.2018.

Përgjigja e ZRRE-së

ZRRE bazuar në nenin 48 paragrafi 3 nën paragrafi 3.3 ku theksohet se gjatë miratimit apo caktimit të tarifave do të siguroj që të licencuarve, t’iu mundësohet kthimi i të gjitha kostove të arsyeshme, duke përfshirë: kostot e niveleve të arsyeshme të humbjeve të energjisë në sistemin e transmetimit dhe shpërndarjes.

ZRRE edhe në PRR2 ka vendosur caqe për reduktimin e humbjeve nga KEDS dhe mos mbulimin e kostove për dështimin në mos arritjen e humbjeve nga ana e KEDS-it.

Koment: Edhe Kryeministri Kosovës publikisht ka premtuar / siguruar se ngritje të çmimit të energjisë elektrike - nuk do të ketë ?!

Përgjigja e ZRRE-së

ZRRE është institucioni i vetëm i mandatauar nga Parlamenti i Republikës së Kosovës, për të trajtuar çështjet rregullative të sektorit të energjisë, përfshirë edhe përcaktimin e çmimeve.

Koment: Qytetari konsumator i energjisë elektrike, sipas formulës së përlllogaritjes, sipas asaj që i faturohet, paguan edhe për INVESTIME por që investimi as aksionariteti nuk i njihet. Nuk i njihen aksionet as nga investimet e së kaluarës, ato nga themeli?!

Përgjigja e ZRRE-së

Kosto Kapitale është kategoria e dytë e kostove pas kostove operative dhe mirëmbajtjes. Në këtë kategori bëjnë pjesë investimet kapitale të bëra nga kompanitë energjetike të cilat kalojnë në MAR si zhvlerësim dhe kthimi në investime në vlerën asetëve të financuara nga kompania por jo edhe në vlerën e dhënë si donacione apo kontribute të konsumatorëve. Sipas Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, ZRRE gjatë miratimit apo caktimit të tarifave, siguron që të licencuarve t’u mundësohet kthimi i të gjitha kostove të arsyeshme me qëllim që të arrihet siguria e furnizimit me energji elektrike për të gjithë konsumatorët. Këto janë parime rregullatore që aplikohen nga të gjithë rregullatorët evropian.

Koment: Meqë operatorët energjetik akoma nuk i përmbushin shumicën e komponenteve të standardeve socio-ekonomike-teknike-humane-mjedisore-shëndetësore...ZRRE-ja duhet të insistojë në përmbushjen / zbatimin e tyre konform Direktivave të BE-së e jo konform presioneve politike;

Raporti / niveli i zbatimit të komponenteve të standardeve duhet të jenë vendimtarë gjatë proceseve të vlerësimit dhe caktimit të çmimeve. Këto procese duhet të angazhojnë edhe qytetarin konsumator takspagues.

Aplikimi i standardeve është kusht edhe për sigurim e risigurim të operatorëve nga përgjegjësia ndaj palës së tretë, që në këtë rast është qytetari dhe biznesi konsumator, te kompanitë e sigurimit e risigurimit. Kjo pa aftësi e operatorëve energjetik po ndikon që mos të mbulohen / mos të kompensohen dëmet që operatorët energjetik po ia shkaktojnë qytetarit dhe biznesit konsumator.



Kjo na kushtoi e po na kushton tepër shtrenjt para, nga dhe pas datës 06.06.2014, kur ndodhi shpërthimi në KEK - fajtori i të cilit akoma nuk është zbuluar por arbitrarisht e padrejtësisht “fajtor” është shpallur qytetari konsumator taksapagues;

Përgjigja e ZRRE-së

Sa i përket dëmit direkt i cili mund të shkaktohet nga operatorët e licencuar në Sektorin e energjisë ndaj konsumatorëve ju informojmë se kjo është e rregulluar me Rregullën për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji. ZRRE po ashtu ju informon se është në përfundim të Rregullores sa i përket ofrimit të shërbimeve nga të licencuarit e në të cilën do të përfshihen edhe kompensimet në rastet kur operatorët e licencuar nuk ofrojnë shërbimet e përcaktuara me legjislacionin primar si dhe sekondar të nxjerr nga ZRRE.

Koment: ZRRE-ja duhet ta anulojë “tarifën për leximin” e njehsorit që është taksë e kontrabanduar për RTK-në. Kuvendi e Qeveria e Kosovës, bashkë me ZRRE-në, duhet ta lejojnë qytetarin konsumator, edhe të ofertës së Skemave programore të kanaleve të RTK-së, që raportet me RTK-ë t’i sqarojë e rregullojë vet;

Përgjigja e ZRRE-së

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës me datë 16 tetor 2009 ka nxjerrë vendim për masën e përkohshme për ndalimin e zbatimit të mëtejme të dispozitës së nenit 20.1 të Ligjit mbi RTK-në lidhur me pagesën e taksës për emetuesin publik RTK në vlerë prej 3.5€, dhe nga kjo periudhë kjo taksë nuk aplikohet në faturat e energjisë elektrike.

Faturat e energjisë elektrike të aplikueshme në Kosovë përmbajnë: ngarkesa për energji (aktive dhe reaktive) që janë lidhura me blerjet e energjisë nga gjeneratorët dhe importi, ngarkesën për fuqi e lidhur me kapacitetin, investimet kapitale në rrjete dhe “tarifën për leximin” apo ngarkesa fikse-mujore e aplikueshme te secili konsumator e cila përbënë kostot e faturimit, inkasimit, shërbimet e konsumatorëve etj.

Koment: - ZRRE-ja duhet t’ia ndalojë KEDS-it që kundërligjshëm t’i përvetësojë trafot e pronësisë private të konsumatorëve e bizneseve - si kusht për mirëmbajtje si dhe t’i deklarojë ato si investime ?!

Përgjigja e ZRRE-së

Asnjë konsumator-biznes i cili ndërton trafon e tij, përfshirë edhe linjat e furnizimit nuk mund të detyrohet nga OSSH që të njëjtën ta dorëzoj tek operatori i shpërndarjes. Stabilimentet të cilat dorëzohen tek Operatori i Shpërndarjes nga disa biznese-kryesisht ato të cilat bëjnë ndërtime kolektive me marrëveshje dorëzohen tek operatori për mirëmbajtje për shkak të mundësisë më të lehtë dhe më të sigurt të mirëmbajtjes si dhe ndërhyrjeve në rastet e nevojshme. ZRRE gjatë shqyrtimit të investimeve nuk i pranon si investime të Operatorit të shpërndarjes stabilimentet e ndërruara nga investitorët.

Koment: Nëse isha i vëmendshëm në lexim / analizë / studim them se nuk vëreja askund se po kërkohet / insistohet në kursime e manaxhim të vëmendshëm të aseteve / mjeteve / energjenteve...si dhe në prokurim.



Ofertat / kërkesat për ofertë në saje të çmimit ekonomikisht më të volitshëm nënkupton ÇMIMIN MË TË VOLITSHËM EKONOMIK KONFORM STANDARDEVE VENDORE DHE TË BE-së. Të bazuarit vetëm në “çmim” por jo edhe në “ekonomikisht më të volitshëm” dhe jo “konform standardeve” flet se gjuha dhe teksti që lënë të nënkuptohet qëllimisht dhe për përfitime personale e grupe po keqkuptohet e kurdiset / manipulohet tenderi?! Vetëm nga blerja e derivateve të naftës, mazutit...po shpenzohen mbi 40 MLN EUR / vit. Për të mbikqyrë e ulur shpenzimet në këtë sektor të KEK-ut, sepse është dyshuar e po dyshohet për keqpërdorime, janë vendosur edhe kamerat, por...

Kontratat / tenderet e pa arsyetuara / të pakompletuara / të dyshuara ZRRE jo vetëm se nuk duhet t’ua arsyetojë operatorëve e mbështes por, përkundrazi, duhet t’i disiplinojë.

Përgjigja e ZRRE-së

ZRRE në pajtim me kompetencat ligjore, është përgjegjëse për monitorimin e operimit të tregjeve të energjisë elektrike, në mënyrë që të sigurojë funksionimin efikas të tyre, si dhe të identifikojë veprimet korrigjuese që mund të jenë të nevojshme.

ZRRE ndër tjera bënë monitorimin e investimeve, importit dhe eksportit të energjisë elektrike të realizuar nga KESCO dhe KOSTT në kuadër të aktiviteteve të tyre të përditshme për të balancuar sistemin energjetik të Kosovës, duke kryer edhe vizita tek palët përgjegjëse. Qëllimi i këtyre vizitave ishte që ZRRE të sigurohet që janë duke u aplikuar të gjitha procedurat e prokurimit të energjisë sipas legjislacionit në fuqi.

ZRRE përveç që bazohet në raportet e audituara, i ka obliguar me legjislacion sekondar të licencuarit të përgatisin Raportet rregullative të audituara për rregullatorin lidhur me shpenzimet operative, kapitale, të hyrat e ndara për aktivitetet e rregulluara nga ato të parregulluara.

Koment: Flitet se deri në 2.5 MLRD EUR i janë dhënë sistemit energjetik të Kosovës si donacione, subvencione, kredi pa kthim...nga miqët ndërkombëtarë. Por, nga ZRRE-ja nuk kemi informatë as konsideratë...se këto mjete e kanë relaksuar sado pak xhepin dhe obligimet e qytetarit konsumator taksapagues ndaj sistemit energjetik.

Përgjigja e ZRRE-së

ZRRE me rastin e përcaktimit të MAR-eve të gjitha subvencionet, donacionet dhe kreditë pa kthim i zbrit nga MAR-et dhe nuk barten në tarifatat e konsumatorëve tarifor.